

**SUPREME COURT OF KOSOVO**  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
**VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL**  
**KOLEGJI I APELIT TË AKP-së**  
**ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-172/13**

Prishtinë, 8 Prill 2015

Në çështjen juridike të:

S. P.

Prishtinë

**Pala ankuese**

Kundër

M. M. S.

Prishtinë

**Pala përgjegjëse në ankesë**

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Willem Brouwer dhe Rolandus Bruin, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/195/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA16491) të datës 18 prill 2013, pas seancës gjyqësore të mbajtur më 8 April 2015, mori këtë:

## AKTGJYKIM

1. Hidhet si e palejueshme ankesa e S. P., për shkak te mungesës se interesit juridik.
2. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/195/2013 (lidhur me lëndën e regjistruar në AKP me numrin KPA16491) i datës 18 prill 2013.

### Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 30 2006, M. S. (në tekstin e mëtejme: pala përgjegjëse në ankesë), ka paraqitur kërkesë në emrin e vet dhe të tre vëllezërve të tij ku kërkonte vërtetim të së drejtës pronësore dhe ri-posedim të dy ngastrave: nr. 196/2 me sipërfaqe prej 2 ari 74m<sup>2</sup> dhe 197/1 me sipërfaqe prej 31 ari 18m<sup>2</sup> pra gjithsejtë 33 ari 92 m<sup>2</sup> që ndodhët në Bare-Plac dhe Bara-Kucni Plac, në Zonën Kadastrale Nëntë-Jugović, Komuna e Prishtinës. (në tekstin e mëtejme të referuara si: pronat). Ai thekson se pronat e tij janë uzurpuar dhe se posedimi i tyre është humbur për shkak të konfliktit të armatosur gjatë viteve 1998/99, ku ceket data 26 qershor 1999 si data e humbjes
2. Për të mbështetur kërkesën e tij pala përgjegjëse në ankesë ka dorëzuar provat vijuese:
  - Fletën poseduese nr. 6 të lëshuar nga Drejtorati për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë i Komunës së Prishtinës me datën 8 shkurt 2009;
  - Vendimin mbi Trashëgiminë nr.188/94 të datës 11 tetor 1994, të lëshuar nga Gjykata Komunale e Prishtinës (tani e tutje i njohur si: Vendimi mbi Trashëgiminë);
  - Një kopje të letërnjoftimit të M. S.;
  - Një kopje të letërnjoftimit të S. S.;
3. Kërkesa është regjistruar në AKP me numrin e lëndës KPA16491;
4. Bazuar në Vendimin mbi Trashëgiminë, pala përgjegjëse në ankesë dhe vëllezërit e tij kanë trashëguar pronat nga babai i tyre i ndjerë, secili nga ta një pjesë ideale prej ¼ të pronave të kërkuara. Certifikata mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme nr. UL-71914021-00006 e lëshuar nga Drejtorati i Kadastrit - Prishtine më 10 gusht 2008 vërteton se e drejta

- pronësore mbi pronat e kërkuara është transferuar nga babai i paraqitësit të kërkesës te paraqitësi i kërkesës dhe tre vëllezërit e tij.
5. Sipas Raportit të Konsoliduar të Verifikimit të AKP-së të datës 20 prill 2011, dokumentet e sipër-përmendura janë verifikuar pozitivisht nga Sekretaria Ekzekutive.
  6. Identifikimi fizik i pronave është bërë më 16 gusht 2012 bazuar në koordinatat e GPS-it, ortofotos dhe planit kadastral. Verifikimi ka treguar se prona është tokë e pa kultivuar dhe nuk është e uzurpuar.
  7. Kërkesa është kundërshtuar nga S. P. (në tekstin e mëtejme: pala ankuese) i cili është paraqitur në AKP si palë përgjegjëse në kërkesë duke kërkuar të drejtën ligjore mbi ngastrat e kërkuara 196/2 dhe 197/1 dhe ku ka theksuar se ai kishte blerë 10 ari të pronave të kërkuara në vitin 1995 nga vëllai i paraqitësit të kërkesës.
  8. Më 11 mars 2013, KKPK vendosi të mbajë një seancë në mënyrë që të ofroj disa informata shtesë lidhur me kërkesën.
  9. Pas seancës, Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK) më 13 qershor 2013, me vendimin e vet KPCC/D/A/195/2013 vendosi të:
    - miratoje kërkesën për sipërfaqen prej 23 ari dhe 92 m<sup>2</sup> të ngastrave nr. 196/2 dhe nr. 197/1;
    - të vërtetoj palën përgjegjëse në kërkesë S. P. si bashkëpronar të ligjshëm të pjesës prej 10 ari të pronave të kërkuara, respektivisht të ngastrave nr. 196/2 dhe nr.197/1.
  10. Vendimi i është dorëzuar palës ankuese më 13 qershor 2013.
  11. Më 20 qershor 2013, pala ankuese ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme ku kundërshtonte vendimin e KKPK-së. Ai ishte thirrur në zbatimin e gabuar të së drejtës së aplikueshme materiale apo asaj procedurale dhe në vërtetimin jo të plotë të gjendjes faktike.
  12. Së bashku me ankesën pala ankuese kishte paraqitur dokumentet (kopjet) vijuese si prova:
    - Aktin e dëshmisë së dëshmitarit M. Y.;
    - Fletën poseduese të lëshuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës më 25 prill 2003;
    - Letrën me numër të referencës KPA16491/RES të lëshuar nga AKP-ja më 31 maj 2010 për palën përgjegjëse në kërkesë S. P.;
    - Kopjen e letërnjoftimit të S. P.;
    - Kopjen e letërnjoftimit të M. I.;

## **Pretendimet e palëve**

13. Pala ankuese, S. P. pretendon të drejtën ligjore ndaj pronave të kërkuara. Ai ka theksuar se ai i ka blerë pronat në vitin 1995 nga M. S. dhe se M. Y. ishte i pranishëm si dëshmitar kur ai i kishte paguar shumën prej 5000 DM M. S. për pronën. Në aktin e dëshmisë është përmendur se dëshmitari M. Y. kishte kontaktuar M. S., i cili gjatë ekzekutimit të kontratës joformale të shitblerjes, ka shënuar fizikisht 10 arët përkatës pa përmendur se për cilën ngastër ishte fjala. Pala ankuese gjithashtu ka theksuar se në mars të vitit 2001 ai kishte ndërtuar një shtëpi në pjesën e blerë të pronës së kërkuar, për qëllime banimi.
14. Pala përgjegjëse në ankesë deklaron se asnjëra nga ngastrat e kërkuara nuk është shitur nga ai apo nga ndonjëri prej vëllezërve të tij. Ai thekson se deklaratat e S. P. në të cilat ai pretendon se ai ka blerë ngastrën e tokës nga vëllai i palës përgjegjëse në ankesë në vitin 1995 është e pavërtetë. Për ta vërtetuar deklaratën e tij ai ka dorëzuar Certifikatën mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme nr.UL-71914021-00006 të lëshuar nga Drejtorati i Kadastrit i Prishtinës më 10 gusht 2008, e cila ishte verifikuar pozitivisht dhe e cila përmend palën përgjegjëse në ankesë dhe vëllezërit e tij si bartës të së drejtës pronësore mbi pronat e kërkuara.

### **Arsyetimi ligjor**

#### *Pranueshmëria e ankesës*

15. Ankesa është e pranueshme. Ajo është paraqitur brenda afatit prej 30 ditëve siç parashihet me nenin 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079.

#### *Juridiksioni*

16. Gjykata Supreme ka juridiksion që ta shqyrtojë ankesën.
17. Pala ankuese në ankesën e saj nuk ka specifikuar ndonjë shkelje të ligjit të aplikueshëm. As Gjykata Supreme gjatë shqyrtimit të lëndës dhe pretendimeve të palëve nuk ka gjetur gabim thelbësor dhe as zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe asaj procedurale apo vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.
18. Pala ankuese nuk ka interes juridik pre të paraqitur ankesë pasi në vendimin ankimor është vendosur në favor të saj. Me vendimin e kundërshtuar të KKKP-së konfirmohet se pala

ankuese është bashkëpronar i pronave të kërkuara, respektivisht të ngastrave nr. 196/2 dhe nr. 197/1 ne sipërfaqe prej 10 ari aq sa është kërkuar përpara AKP-se si dhe dhe nuk është lëshuar urdhër i dëbimit.

19. Bazuar ne sa me sipër, vendimi nuk ka ndonjë efekt ligjor negativ për palën ankuese. Nga dokumentet e administruara në dosje të lëndës, posaçërisht nga ortofoto dhe kopja e planit, Gjykata Supreme vëren se pala ankuese ka ndërtuar një shtëpi në pronë e kërkuar bashkëpronarë të së cilës janë pala përgjegjëse në ankesë dhe vëllai i tij. Pasi që pjesa përkatëse e secilit bashkëpronarë nuk është specifikuar, ata janë bashkëpronarë në pjesë ideale dhe toka nuk është e ndarë.
20. Në këtë kontekst, Gjykata Supreme vjen në përfundim se ndarja e pjesëve përkatëse duhet të bëhet me iniciativën e palëve të përfshira përpara gjykatës kompetente, me qëllim të ndryshimit të titullarit të bashkëpronësisë në pronësi. Kjo do të thotë se KKPK-ja ka vendosur drejt kur e ka vërtetuar pronësinë e palës ankuese.
21. Pasi që pretendimet e palës ankuese janë pranuar nga KKPK-ja, palës ankuese nuk ka interes të nevojshëm ligjor që të parashtrijë ankesë. Ekzistenca e interesit ligjor është një parakusht absolut procedural për lejueshmërinë e kërkesës, ankesës, etj, në procedurën civile siç parashihet me nenin 2.4 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore. Kjo ka të bëjë me mungesën e interesit ligjor në përgjithësi lidhur me papranueshmërinë sipas nenit 186.3 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.
22. Prandaj, në këtë rast specifik, ankesa e tanishme duhet të hidhet në përputhje me nenin 13.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 dhe nenit 186.3 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.
23. Nga sa u tha më lartë dhe në përputhje me dispozitat e nenit 12.2 të Ligjit nr. 03/L-079 dhe nenin 196 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **Këshillë ligjore**

24. Sipas nenit 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo atyre të jashtëzakonshme juridike.

*Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit*

*Willem Brouwer, Gjyqtar i EULEX-it*

*Rolandus Bruin, Gjyqtar i EULEX-it*